



Në mbështetje të nenit 64.2 pika (a) dhe (b) dhe neneve 68, 82, 83, 107 dhe 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe nenit 20 dhe 29.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023 miraton këtë:

RREGULLORE NR. 05/2023
PËR THEMELIMIN DHE NDËRRIMIN E QENDRAVE TË VOTIMIT

Neni 1
Fushëveprimi

Kjo Rregullore përcakton kriteret teknike për vendndodhjen e Qendrave të Votimit (QV) dhe Vendvotimeve (VV), procedurat për themelimin si dhe publikimin e QV, mënyrën e ndërrimit të QV dhe publikimin e Listës Preliminare të Votuesve (LPV).

Neni 2
Kriteret teknike për vendndodhjen e QV

1. Vendndodhja e QV duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:
 - 1.1. Objekti/ndërtesa duhet të ketë së paku një hyrje, e cila duhet të jetë lehtësisht e qasshme;
 - 1.2. objekti/ndërtesa duhet të ketë ndriçim të mjaftueshëm;
 - 1.3. duhet të ketë qasje të lehtë për votim të personave me aftësi të kufizuar;
 - 1.4. objekti duhet të ketë tavolina dhe karrige;
 - 1.5. të ketë së paku një tualet;
 - 1.6. të ketë energji elektrike.

Neni 3
Vendndodhja e QV dhe VV

1. QV është vend i caktuar për zhvillimin e procesit të votimit në përputhje me LZP dhe LZL.
2. QV themelohen në:

- 2.1. Ndërtesa të institucioneve publike; arsimore, kulturore, sportive, etj., me prioritet në çdo shkollë fillore;
- 2.2. ndërtesa private në pronësi të personave fizikë ose juridikë, vetëm pas miratimit nga KQZ, kur nuk është e mundur sipas paragrafit 2 dhe nën paragrafit 2.1 të këtij neni.

Neni 4

Procedurat për themelimin e QV dhe VV

1. Në bazë të nenit 83 të LZP, mundësisht asnjë votues, nuk duhet të udhëtojë më shumë se 3 km deri në VV e tij/saj.
2. KQZ përmes ZEKKZ kujdeset që të bëjë analizën dhe vlerësimin e QV aktuale të votimit, por që mund të propozojë themelimin e QV të reja.
3. Kërkesat për themelimin e QV të reja mund të bëhen nga bashkësitë lokale, administratorët apo kryetarët e fshatrave, qytetarët apo subjektet politike, në komisionin komunal të zgjedhjeve (KKZ, përmes shtojca I: Formulari i kërkesës për themelimin e QV.
4. Mbështetur në paragrafin 3 të këtij neni, ZEKKZ/KKZ bën vlerësimin teknik të objektit që është kërkuar të krijohet si QV, ndërsa KQZ bënë identifikimin e votuesve që mund të caktohen në QV, brenda dhjetë (10) ditë pas pranimit të kërkesës.
5. Pas analizës së kërkesave për themelimin e QV të reja, KQZ vendosë brenda pesë (5) ditëve.

Neni 5

Publikimi i QV

1. KQZ publikon në faqen zyrtare, lokacionet e QV, jo më vonë se dyzet (40) ditë para ditës së zgjedhjeve.
2. Në ato komuna ku zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune, numri i QV dhe lokacionet e tyre janë të njëjta si në raundin e parë.

Neni 6

Caktimi i votuesve në QV dhe publikimi i listës së votuesve

1. KQZ cakton votuesit nëpër QV.
2. Me qëllim të informimit të votuesve me të drejtë vote, ofrimit të mundësisë për ndërrimin e QV dhe kundërshtimit e konfirmimit të listës së votuesve LV, KQZ bën publike Listën preliminare të Votuesve (LPV) në platformën elektronike (online) dhe në zyre të KKZ.

- 2.1. Ekstrakti i parë i LV publikohet jo më vonë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes së datës së zgjedhjeve;
- 2.2. ekstrakti i dytë i LV, do të publikohet pesëdhjetë e katër (54) ditë para ditës së zgjedhjeve.
3. Lista e njëjtë e votuesve, që është shfrytëzuar për zgjedhjet komunale, do të përdoret për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, duke përfshirë personat që në ndërkohë, në ditën e zgjedhjeve, mbushin 18 vjet dhe duke përjashtuar personat që heqin dorë nga shtetësia.
4. Të gjithë votuesit me të drejtë vote që janë të përfshirë në listën preliminare të votuesve, kanë të drejtë dhe mundësi të dinë se në cilën QV janë caktuar. Në rast se nuk iu përshtatet QV ku janë caktuar, kanë të drejtë të kërkojnë ndërrimin e QV brenda komunës së njëjtë, në afatet e përcaktuara nga KQZ.

Neni 7

Ndërrimi i QV

1. Kërkesën për ndërrimin e QV votuesi mund ta bëjë në çdo kohë, deri në periudhën kohore dyzet (40) ditë para ditës së zgjedhjeve.
2. Kërkesat për ndërrimin e QV mund të bëhen në KKZ, shtojca II: Formulari për ndryshimin e QV dhe përmes platformës online, në çdo kohë, përveç periudhës kohore 40 ditë para ditës së zgjedhjeve.
3. Kërkesës për ndërrimin e QV, i bashkëngjitet një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:
 - 3.1. Letërnjoftim i vlefshëm;
 - 3.2. pasaportë e vlefshme;
 - 3.3. patent shofer i vlefshëm.
4. Kërkesat për ndërrimin e QV shqyrtohen dhe miratohen nga KKZ dhe ndryshimet reflektohen çdo ditë.

Neni 8

Informimi i votuesve

1. Për nevoja të informimit të votuesve, KQZ do të lansojë një platformë online (makinë kërkuese) dhe linjën telefonike, e cila do të jetë në shërbim të të gjithë votuesve dhe pa pagesë, në çdo kohë gjatë orarit të punës.
 - 1.1. Përmes makinës kërkuese, të gjithë votuesit kanë qasje në informatat e tyre lidhur me QV ku janë caktuar dhe mundësinë për të ndërruar QV.

- 1.2. Linja telefonike do të ju mundësojë qytetarëve të kërkojnë sqarime dhe informata. Kjo linjë telefonike do të jetë në dispozicion të votuesve, në çdo kohë, gjatë orarit të punës, duke përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve.
2. KQZ kujdeset që të realizojë një fushatë të informimit publik dhe të informojë votuesit për mënyrën, formën e identifikimit të QV dhe të drejtën për të kërkuar ndërrimin e QV.

Neni 9

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla Zgjedhore Nr.16/ 2013 për themelimin e qendrave të votimit dhe Rregulla Zgjedhore Nr.17/ 2013 periudha e shërbimit të votuesve për ndërrimin e qendrës së votimit.
2. Pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje janë:

shtojca I: Formulari i kërkesës për themelimin e QV;

shtojca II: Formulari për ndryshimin e QV.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi